

VENDIM
Nr. 946, datë 9.10.2013

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË INTEGRIMIT EVROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Miratimin e misionit dhe të fushave të përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Integrimit Evropian (MIE), sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Ministria e Integrimit Evropian ka për mision drejtimin teknik dhe bashkërendimin e procesit të integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, hartimit të politikave të integrimit, bashkërendimit të ndihmave financiare nga Bashkimi Evropian dhe informimit të publikut për këtë proces.

III. Ministria e Integrimit Evropian ushtron këto veprimtari:

1. Bashkërendon punën dhe monitoron përgatitjet e institucioneve shqiptare dhe angazhimet e ndërmarra prej tyre, në kuadër të procesit të stabilizim-asociimit.

2. Bashkërendon, monitoron dhe raporton për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian, të dala nga takimet e përbashkëta me Bashkimin Evropian, në nivele të ndryshme.

3. Përgatit mekanizmat metodologjikë në funksion të lehtësimit të zbatimit të reformave sektoriale, që rrjedhin nga negociimi dhe zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

4. Bashkërendon punën ndërmjet ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera qendrore për hartimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, me qëllim realizimin e objektivave të përcaktuar në kuadër të procesit të integrimit evropian.

5. Bashkërendon, monitoron dhe analizon ecurinë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, duke mbajtur lidhje të rregullta institucionale me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore.

6. Harton, në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore, planin kombëtar për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, si dhe kontrollon zbatimin e këtij plani dhe të programeve të tjera të lidhura me partneritetin evropian.

7. Vlerëson përputhshmërinë e projektakteve normative të propozuara nga ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore me të drejtën e Bashkimit Evropian, të cilat duhet të pasqyrojnë në relacionin shoqërues shkallën e përafrimit dhe referencat për legjislacionin përkatës dhe jurisprudencën e Bashkimit Evropian.

8. Bashkërendon punën dhe ndihmon ministrinë e linjës e institucionet e tjera qendrore për hartimin e legjislacionit të nevojshëm, me qëllim përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

9. Konfirmon përkthimin e dokumentacionit bazë, të nevojshëm për procesin e përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian.

10. Bashkërendon, programon dhe monitoron ndihmën e Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë (fondet IPA, instrumenti TAIEX, si dhe programe të tjera ndihme, që mund t'i ofrohen Republikës së Shqipërisë), sipas përparësive të vendit tonë, në kuadër të procesit të integrimit evropian.

11. Bashkërendon dhe ndjek nënshkrimin e marrëveshjeve të ndihmave financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të programeve të përcaktuara në pikën 10.

12. Udhëheq dhe bashkërendon punën e ministrive të linjës e të institucioneve të tjera qendrore në përgatitjen e projekteve parësore dhe, në kuadër të programeve të përcaktuara në pikën 10 të kësaj ndarjeje, ia paraqet për mbështetje financiare Bashkimit Evropian.

13. Merr pjesë në veprimtarinë e grupeve të punës, të ngritura nga institucione të tjera shtetërore, për hartimin e programeve të ndryshme për integrimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

14. Shkëmben të dhëna, organizon takime periodike në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar dhe trajnon stafin e ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera në funksion të procesit të integritit evropian.

IV. Ministria e Integritit Evropian në marrëdhëniet me të tretët:

a) bashkërendon punën për hartimin dhe zbatimin e programit për informimin e publikut për çështjet e integritit evropian;

b) propozon ngritjen e grupeve teknike të punës, në funksion të përmbushjes së detyrimeve, që rrjedhin nga procesi i integritit evropian;

c) kërkon nga ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore përgatitjen dhe paraqitjen në afatet e caktuara të dokumenteve, në funksion të procesit të integritit evropian;

ç) njofton organet përkatëse të Bashkimit Evropian për përafrimin e akteve normative vendase me të drejtën e Bashkimit Evropian;

d) përgatit dhe paraqet raporte për procesin e integritit evropian në Komitetin Ndërmintor të Integritit dhe Komitetin e Koordinimit Ndërinstitucional për integrimin evropian;

dh) informon komisionet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të interesuara për procesin e integritit evropian, në përmbushje të detyrimeve kushtetuese.

V. Mënyra e komunikimit të Ministrisë së Integritit Evropian me misionin shqiptar pranë Bashkimit Evropian rregullohet nëpërmjet një udhëzimi të përbashkët të ministrit të Punëve të Jashtme dhe të ministrit të Integritit Evropian.

VI. Ngarkohet Ministria e Integritit Evropian për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama